



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS PODUJEVË

Numri i lëndës: 2024:124586

Datë: 12.07.2024

Numri i dokumentit: 05931343

P.nr.216/24

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA PODUJEVË - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Besnik Sheqiri, me pjesëmarrjen e procesmbajtëses Erblina Aliu, në çështjen penale kundër të pandehurit R. B., për shkak të veprës penale "Lëndimi i lehtë trupor" nga neni 185 par. 1 nën-par. 1.4 dhe veprës penale "Kanosja" nga neni 181 par. 2 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.327/24F, të datës 05.07.2024, në seancën jo publike të shqyrtimit fillestar të mbajtur me datë 11.07.2024, në prezencë të prokurorit të shtetit Vjosa Bytyçi, të dëmtuarës M. B., të pandehurit dhe mbrojtësit të tij të caktuar sipas detyrës zyrtare av. G. N., me datë 12.07.2024 mori dhe publikisht shpalli dhe të njëjtën ditë përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri:

R. B., nga i ati G. dhe nëna H., mbiemri i vajzërisë së nënës Sh., i lindur më ... në fshatin B., Komuna P. ku edhe tani jeton, me numër personal të identifikimit ..., ka të kryer shkollën e mesme, me profesion tregtar, i martuar, baba i katër (4) fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka qëndruar në paraburgim nga data 26.04.2024, deri me datë 11.07.2024.

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

I. Me datë 26.04.2024, rreth orës 16:30^h edhe me par në shtëpinë e tyre të përbashkët në fshatin B., në P., i pandehuri R. B., me dashje që ti shkaktoj lëndime trupore dhe me qëllim të cenimit të dinjitetit në marrëdhënien familjare ka ushtruar dhunë psikike dhe fizike ndaj të dëmtuarës – vajzës së tij M. B., përderisa e dëmtuara me nënën e saj tani dëshmitaren Sh. B. dhe te tjerët kanë shkuar ne qytet dhe pasi që janë kthyer nga qyteti ne shtëpi, i pandehuri e ka pyetur te dëmtuarën se e kunja është kjo çantë, e dëmtuara i ka thënë "e imja", atëherë i pandehuri është nervozuar dhe e ka gjuajtur me një qese që e kishte ne dorë dhe pasi që e dëmtuara ka shkuar ne dhomën e saj, aty ka shkuar i pandehuri dhe e ka sulmuar te dëmtuarën duke e ka kapur për flokëve dhe për fyti dhe duke e goditur disa herë me shuplak ne fytyrë dhe ne pjesë te ndryshme të trupit dhe pasi që e dëmtuara u munduar ta largoj i pandehuri e ka kafshuar ne gishtin e madh te dorës së majtë dhe aty kanë ndërhy dëshmitaret Sh. B. dhe B. B. që ta ndajnë te pandehurin,

e i cili nuk e lejon te dëmtuarën qe te shkoj ne fakultet, me ç ‘rast të dëmtuarës i ka shkaktuar lëndime të lehta trupore, me pasoja te përkohshëm për shëndetin.

- me këtë ka kryer veprën penale “Lëndimi i lehtë trupor” nga neni 185 par. 1 nën-par. 1.4 të KPRK-së.

II. Të njëjtën ditë dhe ne të njëjtin vend si ne dispozitivin e I te kësaj Aktakuze i pandehuri R. B. me dashje dhe me qëllim qe ta frikësoj e ka kanosur te dëmtuarin – vëllain e tij B. B., pasi qe i dëmtuari e ka dëgjuar një zhurmë ne shtëpinë e te pandehurit, ka shkuar dhe aty ka par se i pandehuri po e sulmon vajzën e tij M. B., ka ndërhyrë qe ta ndaj qe mos ta rrah vajzën dhe i ka thënë te pandehuri a po ndalesh a po i thirr policin, atëherë i pandehuri e ka kanosur seriozisht duke i thënë “nuk guxon me i thirr se te vras me dorën time”, me ç ‘rast të dëmtuarit i ka shkaktuar ndenjen e ankthit, frikës dhe pasigurisë për jetë.

- me këtë ka kryer veprën penale “Kanosja” nga neni 181 par. 2 të KPRK-së.

Në bazë të nenit 76 par. 1 te KPRK-se, të pandehurit i:

P Ë R C A K T O N

- Për veprën penale si në ikën (I) Dënim me Burgim në kohëzgjatje prej pesë (5) muaj.
- Për veprën penale si në pikën (II) Dënim me Burgim në kohëzgjatje prej tre (3) muaj.

Andaj, gjykata në bazë të dispozitave ligjore si më lartë dhe neneve 76 par. 2 nën-par. 2.2, 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 42, 46, 47, 48, 49, 50, 69, 70 dhe 79, si dhe të neneve 364, 367 dhe 449 par. 2 nën-par. 2.6 dhe 462 par. 2 të KPP-së, të pandehurin e:

G J Y K O N M E D Ë N I M M E K U S H T

I. Ashtu që i vërteton Dënimin Unik me Burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj, në kuadër të cilit i llogaritet koha e kaluar në paraburgim, ndërsa pjesa tjetër e dënimit nuk do të ekzekutohet nëse në periudhën e verifikimit prej një (1) viti nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi i pandehuri nuk kryen vepra tjera penale.

II. DETYROHET i pandehuri që në emër të shpenzimeve të procedurës penale për paushallin gjyqësor të paguaj shumën prej njëzet (20) Euro dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit poashtu shumën prej njëzet (20) Euro, të gjitha këto në afatin prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

IV. Të dëmtuarit: M. B. dhe B. B., që të dy me vendbanim në fshatin B., Komuna P., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest të rregullt juridiko civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.327/24F, të datës 05.07.2024, kundër të pandehurit R. B., për shkak të veprës penale “Lëndimi i lehtë trupor” nga neni 185 par. 1 nën-par. 1.4 dhe veprës penale “Kanosja” nga neni 181 par. 2 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale, gjyqtari i vetëm gjykues ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datë 11.07.2024, pas hapjes së seancës, konstatimit të prezencës së palëve, udhëzimit për të drejtat dhe detyrimet e tyre, të pandehurit në kuptim të nenit 241 par. 4 të KPP-së, i ofroi mundësinë e deklarimit rreth fajësisë për veprat penale për të cilat është akuzuar.

I pandehuri në seancën e shqyrtimit fillestar, pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësin e tij, ka pranuar fajësinë për veprat penale për të cilat është akuzuar, duke i pohuar në tërësi faktet rreth ngjarjes së ditës kritike të përshkruara si në aktakuzë, më tej ka theksuar se veprimet e tij kanë qenë të momentit të cilat nuk ka mundur t’i kontrolloj për shkak të nervozes, është hera e parë që ka rënë ndesh me ligjin, ndjen keqardhje dhe premtoi se nuk do të përsëris veprimet të tilla apo të ngjashme.

Gjyqtari i vetëm gjykues vërteton se i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i pandehuri pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje ligjore apo gabime faktike, andaj gjatë marrjes në konsideratë të pranimin të fajësisë nga i pandehuri, mori pikëpamjet e prokurorit të shtetit, mbrojtësit të pandehurit dhe të dëmtuarës.

Prokurori i shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga i pandehuri ka deklaruar se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, pasi që ky pranim është bërë konform dispozitave ligjore dhe në përputhje të plotë me atë se për çfarë akuzohet i njëjti, andaj me rastin e përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, si rrethana rënduese të merr për bazë shkallën e lartë të kryesit për të kryer këto vepra penale ku fillimisht ka sulmuar vajzën e tij e më pas kanosur vëllain e tij, po ashtu si rrethanë rënduese të merr për bazë faktin se vepra penale është kryer brenda marrëdhënies familjare, ndërsa si rrethanë lehtësuese të merr pranimin e fajësisë.

Mbrojtësi i të pandehurit av. G. N. lidhur me pranimin e fajësisë nga i pandehuri ka deklaruar se e mbështetë pranimin e fajësisë nga i mbrojturi i tij, ngase pranimi i fajësisë është bërë pas konsultimeve të mjaftueshme me të si mbrojtës, nga gjykata ka kërkuar që me rastin e matjes së dënimit të ketë parasysh rrethanat lehtësuese të cilat janë të përcaktuara në Kodin Penal të Republikës së Kosovës, si rrethanë lehtësuese të merr parasysh faktin se i njëjti është mbajtes i familjes, asnjëherë më parë nuk ka rënë ndesh me ligjin, ka shprehur keqardhje dhe kërkoj falje për veprimet të cilat ditën kritike i ka ndërmarrë ndaj të dëmtuarën vajzës së tij, ka premtuar se në të ardhmen nuk do të përsëris veprën penale, andaj marr parasysh gjendjen e dobët ekonomike të tij si dhe domosdoshmërinë e përkujdesjes ndaj bashkëshortes dhe fëmijëve të tij, gjykatës i ka propozuar që të njëjti t’i shqiptojë një sanksion më të butë penal.

E dëmtuara M. B. lidhur me pranimin e fajësisë nga i pandehuri ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga i pandehuri i cili është babai i saj, e njëjta ka kërkuar që i njëjti të lirohet, duke shpresuar se në të ardhmen nuk do të përsëritet diçka e tillë.

Gjyqtari i vetëm gjykues pas pranimit të fajësisë nga i pandehuri si dhe marrjes në konsideratë të pikëpamjeve të prokurorit të shtetit, mbrojtësit të pandehurit dhe të dëmtuarës, si dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës, vërteton se në veprimet inkriminuese të pandehurit të ndërmarra në kuadër të dashjes së tij, manifestohen të gjitha elementet qenësore të figurës së veprave penale “Lëndimi i lehtë trupor” nga neni 185 par. 1 nën-par. 1.4 dhe veprës penale “Kanosja” nga neni 181 par. 2 të KPRK-së, andaj pasi që më parë gjeti se në aspektin penal-juridik është përgjegjës, të njëjtin e shpalli fajtor dhe i shqiptoi sanksionin penal si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, gjyqtari i vetëm gjykues mori parasysh të gjitha rrethanat e mundshme lehtësuese dhe ato rënduese të parapara me nenin 69 dhe 70 të KPRK-së, të cilat janë me ndikim me rastin e marrjes së vendimit, ashtu që në rastin konkret si rrethana lehtësuese mori parasysh pranimin e fajësisë nga i pandehuri, keqardhjen e shprehur për veprimet e tij të cilat ditën kritike i ka ndërmarrë ndaj të dëmtuarve vajzës dhe vëllait të tij, premtimin se në të ardhmen nuk do të përsëris veprën penale, nga të dhënat e siguruar nga Evidenca penale, nuk rezultoi të ketë qenë i gjykuar më parë për ndonjë vepër tjetër penale, ndërsa si rrethanë rënduese për të pandehurin mori parasysh prezencën e dhunës ose kanosjes me dhunë në kryerjen e veprës penale, viktima e veprës penale ka qenë posaçërisht e pambrojtur apo e ndjeshme, moshë e viktimës, ... vjeçare, vepra penale është kryer brenda marrëdhënies familjare, andaj mbi bazën e arsyeve dhe rrethanave të sipër theksuara gjyqtari i vetëm vlerësoi se dënimi me kusht si dënim alternativ i shqiptuar të pandehurit, është në proporcion me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të tij, me bindje se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit me kusht i paraparë me nenin 47 të KPRK-së, i cili konsiston në risocializimin e të pandehurit me anë të pezullimit të dënimit, me të cilin dënim të pandehurit seriozisht i tërhiqet vërejtja dhe i bëhet me dije se nëse i njëjti kryen vepër tjetër penale brenda periudhës së verifikimit të përcaktuar si në pikën (I) të dispozitivit të këtij aktgjykimi, gjykata do të revokojë dënimin me kusht dhe do të urdhërojë ekzekutimin e dënimit të caktuar në dënimin me kusht.

Vendimi mbi mundësinë e revokimit të dënimit me kusht është marrë në bazë të nenit 50 të KPRK-së.

Vendimi mbi llogaritjen e paraburgimit në dënimin e shqiptuar është marrë në bazë të nenit 79 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është marrë në bazë të nenit 449 par.1 dhe 2 nën par. 2.6 të KPP-së dhe vendimi në emër të kompensimit të viktimave të krimit është marrë konform nenit 36 par.3 nënpar.3.1 të Ligjit nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarve për realizimin e kërkesës pasurore juridike në kontest të rregullt juridiko civil është marrë në bazë të nenit 462 par. 2 të KPP-së.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 242 dhe 364 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA PODUJEVË
Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal
P.nr.216/24, Datë 12.07.2024

Procesmbajtëse
Erblina Aliu

Gjyqtari i vetëm gjykues
Besnik SHEQIRI

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.